

VENDIM
Nr. 379, datë 26.4.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR TË UJËRAVE TË ZEZA DHE I.T.U.P NË
ZONËN TURISTIKE GJIRI I LALËZIT, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në zonën turistike gjiri i Lalëzit, Durrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “arë” me sipërfaqe të përgjithshme 10 475 (dhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 4 158 575 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasurinë “arë”, prej 4 158 575 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri shpronësime për objektet buxhetore, për programin furnizimi me ujë dhe kanalizime, me kodin M063141.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurisë, për të cilën është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve si dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasurinë e shpronësuar, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA "NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR TË UJËRAVE TË ZEZA
 DHE I.T.U.P. NË ZONËN TURISTIKE GJIRI I LALËZIT, DURRËS"

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr.pas	Lloji i pas.	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Mbiemri								
1	Zihni Besnike Devis Rexhep Klodjan	Dana	2332	527/10	Arë	10475	10475	397	4158575	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE						10475		4158575	